



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, më 20.01.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Armend Zemaj.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Avni Ukaj-BOTA SOT; Xhemajl Slllovinja-KOSOVA PRESS; Dukagjin Maliqi-RTV-DUKAGJINI; Norë Shabani-KOHA DITORE; Mërgime Kajtazi-KDI; Shefki Kastrati, NDI; Lumturie Beka, KOSOVA INFO, Florina Merovci, ZPRK, Shqipe Osmani, BOTA PRESS; Sahadete Zogaj, KOSOVA PRESS; Dren Ajeti, GSJP- Blerta Bejtullahu-EUSK-EU-Office dhe Petrit Hysaj – OSBE.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi znj. Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 01. 07; 08, 11 dhe 14.12.2015;
3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Diskutim për planin e punës për vitin 2016 dhe për aktivitetet e grupeve punuese;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja-E hapi mbledhjen dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit, duke uruar një vit të mbarë për të gjithë. Në vazhdim, kryesuesja tha se më me dëshirë do niste këtë mbledhje sikur të ishin prezent edhe opozita, dhe në emër të komisionit i fton që t'i bashkohen punës, si në komision, ashtu edhe në seancat e Kuvendit.

Ajo propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pika shtesë, si vijon;

- Dërgimi i raportit AKK-së lidhur me zbatimin e Objektivave që dalin nga Strategjia kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2013-2017,
- Informatë lidhur me rishpallje e Konkursit për anëtarin e Këshillit gjyqësor nga Oda e Avokatëve.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 01. 07; 08. 11 dhe 14.12.2015

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 01. 07; 08, 11 dhe 14.12.2015, pa vërejtje.

3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2015

Kryesuesja e njoftoi komisionin se ky raport është i përgatitur nga Zyra mbështetëse e komisionit, dhe hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Armend Zemaj - Shprehu keqardhje që pjesa tjetër e anëtarëve të komisionit nuk ishin prezent, duke thënë se kjo mungesë reflekton edhe në raportin e punës se vitit 2015.

Në lidhje me raportin, Zemaj theksoi se në të janë paraqitur të gjitha aktivitetet e komisionit në pika të shkurtra, duke konstatuar për ngarkesën që ky komision ka pasur, qoftë nga procedimi i ligjeve, raporteve, por edhe plotësim-ndryshimeve që kanë ardhur në forma të ndryshme, përfshirë detyra në kuadër të kompetencave të komisionit.

Më tej Zemaj kërkoi që raporti duhet ndryshuar në disa pika, praktikë e cila duhet të aplikohet edhe nga komisionet e tjera, pasi sipas tij është e domosdoshme të pasqyrohen më në detaje aktivitetet e komisionit, më pas puna e deputetëve, si anëtarë të këtij komisioni. Ai me tej sqaron se në publik vazhdimisht thuhet dhe kërkohet llogaridhënia për punën, dhe pikërisht kjo është arsye që sipas tij duhet të pasqyrohet sa dhe kush janë pjesë e të gjitha këtyre aktiviteteve, pasi në fund paguhen njëjtë. Zemaj kërkoi që në raportet e ardhshme të reflektohet kjo dhe të jenë më të zgjeruara, qoftë ato të udhëheqjes së grupeve punuese, marrja e detyrave shtesë, etj.

Zemaj nuk la pa theksuar se si shkak i zhvillimeve të fundit, pengesat të cilat janë reflektuar në mbikëqyrjen parlamentare dhe atë që komisioni nuk ka pasur mundësi, sidomos në gjashtë mujorin e fundit, ta ketë efikasitetin e duhur në mbikëqyrjen e agjencive të cilat i raportojnë vetë komisionit dhe në ligjet e tjera të cilat janë specifike për vendin. Në këtë theks, Zemaj përmendi reformën e fundit në sistemin e drejtësisë dhe ardhjen prapë në fund të vitit të ligjeve për plotësim-ndryshim, që sipas tij po të ekzistonte mundësia e ushtrimit të veprimtarisë së plotë të komisionit, kjo do të ishte rregulluar në afatin e mundshëm kohor.

Megjithatë, Zemaj tha se mbi të gjitha, lufta kundër krimit dhe korrupsionit është pengesa kryesore dhe bie në hartimin e legjislacionit, derisa mbikëqyrja e Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe agjencive të tjera, si agjencia e pronave, agjencia për ndihme juridike falas, etj. të gjitha sipas tij është dashtë që të kenë raport të mbikëqyrjes, por sipas Zemajt nuk është faji i tyre, por i Kuvendit dhe mënyra se si jemi futur në këtë agjendë legjislative.

Në fund Zemaj shtoi se të gjitha këto vërejtje është dashtë të jenë pjesë e këtij raporti, si të arriturat ashtu edhe ngecjet që kanë mbetur për vitin 2016, dhe sipas tij vetëm atëherë mund ta quajmë këtë raport si raport pune, pasi ai mbetet dokument dhe jo vetëm kuvendi, por edhe të tjetër mund ta marrin si një pasqyrë për zhvillimet e aktivitetet e komisionit, në të kundërtën është vetëm një informatë se çka ka bërë komisioni për hartim të ligjeve, procedurave të rregullta etj., gjatë vitit 2015.

Agim Aliu-Mes fjalëve përshëndetëse që tha për të gjithë të pranishmit, theksoj se rrethanat që kemi punuar në vitin e kaluar po barten edhe në këtë fillim vit dhe nuk po japin shpresë se do të mund të punojmë në një normalitet. Kjo tregon për vështirësitë që komisioni ka pasur vitin e kaluar dhe gjithashtu sfidat që na presin edhe këtë vit. Të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe asnjëri nga ne nuk besoj të ndihet mirë që mbajmë mbledhje pa prezencën e opozitës, deputeti **Aliu** përmendi edhe faktin se gjatë kohës kur komisioni ishte në përbërje të plotë ka dominuar një frymë pozitive që punën ta kryejmë me dinjitet dhe asnjëherë nuk ka ardhur në shprehje militantizmi. Megjithatë në lidhje me raportin, potencon se në këtë raport është pasqyruar puna e komisionit në mënyrë të detajuar, por duke ditur se ky komision është një ndër me të rëndësishmit në kuvend, dhe duke ditur se sa shume pengesa kishin si komision sidomos në sesionin vjeshtor deputeti Aliu tha se ndihet mirë që puna dhe përgjegjësitë që kanë pasur janë përfunduar mirë. Ai në mënyrë të veçantë theksoi punën që komisioni ka bërë me shqyrtimin e ligjeve që kanë të bëjnë me drejtësinë në vend. Ky edhe ishte qëllimi që na ka bashkuar dhe shprehu keqardhje që tani nuk janë bashkë të gjithë që të punojnë dhe të dëshmojnë para qytetarëve, shoqërisë civile dhe partnereve që i përkrahin se vërtet punohet që në Kosovë të sundojë rendi dhe ligji. Me rekomandimin që në raport të falënderohen edhe shoqëria civile dhe partneret që mbështesin komisionin z. Aliu përfundon fjalën duke thënë se raporti duhet të miratohet nga komisioni.

Agim Ademaj- Në fjalën e tij përshëndeti të pranishmit, më tej shtoi se nuk do të përsërite fjalët që thanë para folësit në lidhje me raportin. Deputeti Ademaj përfundon fjalën duke thënë se raporti është punuar mirë, në mënyrë të detajuar është pasqyruar puna e komisionit dhe si i tillë duhet të aprovet nga komisioni.

Doruntina Maloku-Në fjalën e saj tha se është dashur që në detaje të paraqiten edhe puna e grupeve punuese, të cilët në tërësi e kanë kryer punën e tyre gjatë vitit të kaluar dhe mendoj se kjo është mangësi në këtë raport, tha znj. Maloku.

Danush Ademi-Thotë se e përkrah raportin, por ka vërejtje në atë se nuk ka qenë i njoftuar për dy vizita që janë bërë në Shqipëri dhe Mal të Zi, dhe kërkon që në të ardhmen të njoftohet me kohë.

Kryesuesja- Në fjalën e saj të sërishme thotë se ky raport është i punuar nga njësi për mbështetje të komisionit dhe në mënyrë statistikore kryesuesja paraqiti punën e komisionit gjatë vitit 2015. Ajo thotë se është shqetësuese puna që është bërë në projektligjin për konfliktin e interesit që dy herë komisioni ka përgatitur raportin me amendamente dhe gjithashtu është futur

në seancën e Kuvendit për lexim të dytë dhe dy herë është tërhequr nga ana e qeverisë dhe nuk është dhënë arsyetim për tërheqje.

Znj. Halimi propozon se në raport duhet të shtohen grupet punuese me emra dhe mbiemra, dhe me tej pas plotësimit të aprovohet nga komisioni dhe t'i dërgohet kryetarit të Kuvendit për informacion dhe gjithashtu të publikohet në ueb faqe që të gjithë të jenë të informuar për punën e komisionit gjatë vitit 2015. Ajo më tej informon se është duke u punuar ende në projektligjin për mjekësinë ligjore, pastaj grupi punues që do të punojë në projektligjin për agjencinë e pronave, dhe grupi punues i formuar që duhet të punojë në projektligjin për pasurinë e konfiskuar dhe sekuestruar. Ajo njoftoi se këto projektligje shumë shpejt do të jenë gati për seancat plenare.

Në fund znj. Halimi bëri thirrje edhe në emër të komisionit që anëtarët e tjerë të komisionit t'i bashkohen punës në komision për çka janë të zgjedhur. Gjithashtu deputetja Halimi falënderon shoqërinë civile që ka dhënë kontribut përmes angazhimit profesional që në të jemi më të kompletuar në realizimin e planit për vitin 2015, gjithashtu falënderon edhe mediat të cilat në mënyrë objektive kanë pasqyruar punën e komisionit dhe uron që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në vitin 2016.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohet raporti i punës së Komisionit për vitin 2015, me vërejtjet e paraqitura.

4. Diskutim për planin e punës për vitin 2016 dhe për aktivitetet e grupeve punuese

Kryesuesja-Në fjalën e saj tha se zakonisht në çdo fillim të vitit komisionet hartojnë planin e punës, por ne, meqë nuk e kemi ende strategjinë legislative nga Qeveria, nuk mund të fillojmë me hartimin e planit të punës për vitin 2016. Ajo më tej informon anëtarët e tjerë të komisionit se OSBE-ja dhe grupi për Studime Juridike Politike, kanë shprehur gatishmëri të na ndihmojnë në hartimin e planit të punës për vitin 2016. Më pas fton që fjalën ta marrë përfaqësuesi nga OSBE-ja.

Petrit Hysaj, përfaqësuesi nga OSBE- Tha se zakonisht mbështesin komisionet në planet e tyre përkatëse të punës, njëjtë është edhe për komisionin për legjislacion. Ne jemi të gatshëm që ta mbështesim komisionin me qëllim që plani të hartohet sa më shpejt.

Kryesuesja- Tha se pritet që shumë shpejt do të kemi strategjinë legislative nga Qeveria dhe do të hartojmë planin e punës për vitin 2016, deri atëherë nuk mund ta kompletojmë dhe miratojmë planin e punës.

5. Të ndryshme

- **Dërgimi i raportit AKK-së lidhur me zbatimin e Objektivave që dalin nga Strategjia kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2013-2017**

Kryesuesja –Tha se komisioni ka formuar një nëngrup punues që do të merret me këtë çështje dhe do të mbikëqyrë zbatimin e objektivave që dalin nga strategjia kundër korrupsionit, por sido që të jetë shton ajo jemi në një situatë ku sesioni vjeshtor, nuk ka funksionuar mjaftueshëm në këtë çështje, për shkak se ky grup punues është udhëhequr nga një anëtarë i komisionit që i përket partive të cilat nuk po marrin pjesë në punën e Kuvendit.

Ajo potencon se sot është afati i fundit që në duhet të dorëzojmë raportin lidhur me zbatimin e objektivave. Znj. Halimi tha se këtë raport me përgjigjet e keni para vetes dhe se si i tillë mund t'i dërgohet agjencisë nga ana e komisionit, por paraprakisht kërkohet një aprovim formal nga ana e komisionit tha në fund deputetja Halimi.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Komisioni i paraqet raport Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me zbatimin e Objektivave që dalin nga Strategjia kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2013-2017, së bashku me matricën e raportimit.

• Informatë lidhur me rishpalljen e Konkursit për anëtarin e Këshillit Gjyqësor nga Oda e Avokatëve

Kryesuesja-Thotë se të gjithë e dimë që kemi pasur intervistimin e kandidatëve nga komuniteti serb për anëtarë të Këshillit Gjyqësor dhe gjithashtu raporti është i përgatitur dhe i dërguar për seancë, ku pritet të futet në rend dite në seancat e radhës, ndërsa për përfaqësuesin tjetër nuk ka pasur kandidatë të mjaftueshëm që në të mund të procedojmë me intervistim.

Më tej Znj. Halimi shton se, si komision, kemi përkrahur një amendament kushtetues dhe kemi proceduar për Kuvend për këtë çështje, ku ndryshon numrin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të cilët zgjidhen nga ana e Kuvendit. Me këtë amendament zvogëlohet numri i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor që zgjidhen nga Kuvendi dhe shtohet numri i anëtarëve të Këshillit të cilët zgjidhen nga vetë Këshilli. Në seancën e fundit nuk kishte kuorum të mjaftueshëm dhe mbeti për seancën e radhës votimi i këtij amendamenti. Prandaj ajo propozon që të mos rishpallet konkursi deri sa të votohet amendamenti kushtetues dhe kjo pjesë, pastaj të zgjidhet nga ana e Këshillit Gjyqësor.

Armend Zemaj-Theksoj se, si komision, kemi arritur që ta bëjmë funksional Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe këtë e kemi pasur si angazhim primar që të mos krijohen atje zbrazëtira ligjore. Ndërsa çështja e personit nga Oda e Avokatëve, e cila është përcjellë në komision edhe unë mendoj se duhet pritur ndryshimi kushtetues dhe të bëhet pjesë e reformës që pretendojmë.

Z. Zemaj shton se ne vetë, si komision, kemi pasur vullnet që i miratojmë ato ndryshime kushtetuese që Kuvendi të jetë sa më larg ndikimit në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit gjyqësor, përveç nëse ka ndonjë zhvillim tjetër ose nuk kalon ai propozim, ne jemi këtu dhe do ta procedojmë sipas ligjit aktual.

Kryesuesja- Në fjalën e saj të fundit thotë se në momentin që do të kalojë amendamenti kushtetues në seancë të Kuvendit do të fillojë iniciativa për plotësim ndryshimin e ligjit. Në fund thekson se ky amendament i propozuar nga qeveria dhe i aprovuar nga komisioni në parim i kontribuon pavarësisë së Gjyqësorit dhe do të ishte mirë nëse kalon edhe në Kuvend.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të mbahet më. 26.10.2016.

Mbledhja përfundoi në orën 11.20.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selviye Halimi

